



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:169032  
Datë: 26.01.2024  
Numri i dokumentit: 05245392

**P.nr.325/2023**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V., Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtares Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurës A.H.nga V., rr. “Brigada – 173”, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhërit ndëshkimor me numër PP.II.nr.1163/2023, të datës 01.08.2023, pas konstatimit të dhënave në aktakuzë, të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor, me datë 26.01.2024, mori këtë:

### AKTGJYKIM

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.1163/2023, të datës 01.08.2023 dhe gjykata, jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

E pandehura A.H.nga V., rr. “Brigada – 173”, nga babai Muhebi, e lindur me datë 02.09.1984, me numër personal 1005505387, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës:

### ËSHTË FAJTORE

Sepse, prej datës së pavërtetuar deri me me datë 09.09.2022, në rrugën “Brigada – 173” në V., pas vërtetimit të gjendjes faktike të njehsorit elektrik nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it, është konstatuar se e pandehura A.H., si shfrytëzuese e energjisë elektrike, me qëllim që vetes ti sjell pasuri të kundërligjshme, ka bërë vjedhjen e energjisë elektrike, ashtu që ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik dhe në këtë mënyrë ka bërë hargjimin e pa autorizuar të energjisë elektrike, me çka ka pamundësuar regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike, duke e dëmtuar të dëmtuarën KEDS-Distrikti në Gjiilan, në vlerë prej 1.110,41 €.

-me këtë veprim ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Numri i lëndës: 2023:169032  
Datë: 26.01.2024  
Numri i dokumentit: 05245392

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 43 të KPRK-së dhe nenit 450, 458, 495 par. 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, të pandehurës së lartcekur:

### **I SHQIPTON Dënim me gjobë**

Ashtu që për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 200.00 € (dyqind euro), të cilin dënim e pandehura obligohet t'a paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

Nëse e pandehura nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk mund t'a paguajë gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të barazohet me 20€ (njëzet) të dënimit me gjobë.

E dëmtuara KEDS, Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet e pandehura që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20€, në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

### **Arsyetim**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 08.08.2023, në Gjykatën Themelore Gjilan, Dega e gjykatës në V., ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.1163/2023, të datës 01.08.2023, ndaj të pandehurës A.H.nga V., rr. "Brigada – 173", për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe është paraqitë kërkesa PP.II.nr.1163/2023, të datës 01.08.2023,, për dhënien e urdhërit ndëshkimor me shqiptimin e dënimit me gjobë, me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par. 2 lidhur me par. 1 të KPPRK-së.

Gjykata pas leximit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor, gjeti se në këtë çështje penalo juridike, janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPPRK-së për dhënien e urdhërit ndëshkimor dhe bazuar në nenin 495 par. 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, vendosi që të pranojë kërkesën e lartë cekur ashtu që të pandehurit t'i shqiptojë dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkëngjitura në të, ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë: procesverbali me numër 2054031, i datës 09.09.2022, procesverbali me numër 2098923, i datës 14.09.2022, fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes, fatura nga kalkulimi i RH, me numër 438702, i datës 23.09.2022, fatura mbi dëmin e shkaktuar me nr DGLHP2213038, i datës 23.09.2022, gjeti se këto janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme mbi bazën e të cilave konstatohet bindshëm se e pandehura ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktin akuzues.

Andaj, bazuar në të lartë cekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë ashtu siç është propozuar në kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së.

Duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktakuzës është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit

Numri i lëndës: 2023:169032  
Datë: 26.01.2024  
Numri i dokumentit: 05245392

të përgjithshëm RH, të cilën e bën vet e dëmtuara gjykata konsideron se të njëjtat nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesërishëm të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-ës, të dëmtuarën KEDS për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Vendimin sa i përket shpenzimeve procedurale, gjykata e mori duke u mbështetur në nenin 450 par. 1 të KPP-së.

Nga të lartë cekurat dhe mbështetur në nenin 495 paragrafi 1, 2 dhe 3, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.**

**Departamenti i përgjithshëm  
P.nr.325/2023, Me datë 26.01.2024**

**Gjyqtarja,  
Blerina Jakupi Ramadani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, gjyqtares individuale të kësaj gjykate. Kundërshtimi nuk duhet domosdo të arsyetohet. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhërin ndëshkimor merr formën e prerë dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.

Numri i lëndës: 2023:169032  
Datë: 26.01.2024  
Numri i dokumentit: 05245392